

U

206/15



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
BASHKIA ROSKOVEC  
Drejtoria Juridike

Adresa, Lagja nr.1 Roskovec, web:www.bashkiaroskovec.com, nr.tel :0382 280242,evisa.mustafaj@yahoo.com

Nr. 150/Prot.

Roskovec, me 18.01.2016

**Lenda:**

***Kthim Pergjigje***

**QENDRES 'RES PUBLICA'**

**TIRANE**

Ne pergjigje te shkreses Tuaj nr.206/15 prot. Ju bejme me dije si me poshte:  
Me date 01.04.2015 , ne fshatin Marinez, gjate veprimtarise hidrokarbure te Kompanise 'Bankers Petroleum Albania Ltd' qe operon ne kete zone, licensuar nga ne Qeveria Shqiptare, ne pusin e naftes nr.5761 ka ndodhur fontana (shperthim i ketij pusi) duke sjelle deme te konsiderueshme materiale ne objektet (shtepi banimi, toke truall, ambiente mbeshtetese) te pronareve perkates.Per kete fatkeqesi te shkaktuar nga veprimtaria njerezore, jane vene menjehere ne levizje institucionet kompetente, konkretisht : Njesia Administrative Kuman, ish Keshilli i atehereshem i kesaj Njesie Administrative, Keshilli I Qarkut Fier, Kompania 'Bankers Petroleum Albania Ltd' si dhe Komisioni i ngritur posacerisht per kete ngjarje, me perfaqesues te Njesise Administrative Kuman, te Keshillit te Qarkut Fier dhe te Kompanise 'Bankers Petroleum Albania Ltd'.

Komisioni I posacem pas verifikimeve perkatese ne vend dhe pas vleresimit te demeve te shkaktuara, ka administruar dosjet per cdo objekt te demtuar.Per sa me siper ka rezultuar se numri i subjekteve te demtuar zona A + zona B eshte 160 (njeqindegjashtedhete) banore keta te demshperblyer per banesat dhe tokat bujqesore.Vlera e pergjithshme e demshperblimit eshte 296 829 451 leke.

Nga kontakte te fundit qe kemi pasur me kompanine "Bankers Petroleum Albania Ltd" , na kane komunikuar verbalisht se jane marre masa per rehabilitim e tokave bujqesore dhe trojeve perreth objekteve te banimit (*sistemim dherash* etj).Gjithashtu , po verbalisht na eshte komunikuar se jane evakuuar rreth 40 (dyzete) familje qe banonin pranesh zones se shperthimit te cilet jane kompesuar nga kjo kompani per gjithe periudhen e evakuimit.

*Bashkengjitur listat emerore dhe velrat perkatese te pronave te demshperblyera.*

*Duke Ju falenderuar per bashkepunimin!*

KRYETAR  
Majlinda BUFI